



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE PËR VITIN 2025

Nr. Rendor	Data e regjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1.	22.01.2025	Kërkesë për informacion për interes të redaksisë së Report TV në lidhje me dy pyetjet: 1. A ka ndërmarrë kryetari i Gjykatës Kushtetuese ose ndonjë anëtar i saj ndonjë akt për të vënë në lëvizje Gjykatën të shprehet mbi datën e mbarimit të mandatit të gjyqtares Sonila Bejtja?	06 .02.2025	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se në datën 30.01.2025 në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur dhe regjistruar kërkesa me kërkues Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me objekt: <i>“Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”</i>, me nr. 1 (P) 2025 të regjistrit themeltar.	E plotë	Nuk ka

		2.A ka gjykata në konsideratë datën 25 prill si datë e mundshme për të mbyllur mandatin dhe rrjedhimisht 25 janarin si datë që gjykata të deklarojë vakancën?		Në këto rrethana, kur Gjykata Kushtetuese do të duhet të shprehet në lidhje me këtë kërkesë, nuk mund të bëjë komente për pyetjet që ju shtroni.		
2.	27.01.2025	Kërkesë për informacion lidhje me dy çështje që kanë të bëjnë me vendimarrjet e Gjykatës Kushtetuese: 1.Cila është arsyeja që vendimi i arsyetuar për deklarimin e përfundimit të mandatit të anëtares dhe Kryetares së Gjykatës znj. Holta Zaçaj, nuk është bërë ende publik pasi	06 .02.2025	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se në datën 30.01.2025 në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur dhe regjistruar kërkesa me kërkues Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me objekt: <i>“Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”</i>, me nr. 1 (P) 2025 të regjistrit themeltar.	E plotë	Nuk ka

		si ligji ashtu dhe Rregullorja parashikojnë publikimin e vendimit brenda 30 ditëve 2.Cili është vlerësimi i Gjykatës për mandatin e anëtares Sonila Bejtja, e cila ka marrë mandatin e ish anëtarit Besnik Muçi, pas dorëheqjes së këtij të fundit. Zoti Muçi, zëvendësoi gjyqtarin (Sokol Berberi) të cilit i mbaroi mandati në 25 Prill 2016. Nëse sipas parashikimeve kushtetuese, ligjore, por dhe të interpretimit të Komisionit të Venecias, mandati aktual i zonjës Bejtja përfundon në 25 prill të vitit 2025, pse nuk është paraqitur kërkesa për		Në këto rrethana, kur Gjykata Kushtetuese do të duhet të shprehet në lidhje me këtë kërkesë, nuk mund të bëjë komente për pyetjet që ju shtroni.		
--	--	---	--	---	--	--

		përfundimin e mandatit dhe nuk është njoftuar organi i emërtesës, në këtë rast Presidenti i Republikës? Rregullorja e Gjykatës Kushtetuese parashikon që “Kryetari, jo më vonë se 4 muaj para mbarimit të mandatit të gjyqtarit kushtetues, i paraqet Gjykatës kërkesë për deklarimin e mbarimit të këtij mandati”. Ndërsa Ligji përcakton se “Kryetari i Gjykatës Kushtetuese, jo më vonë se 3 muaj përpara përfundimit të mandatit të një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese, sipas pikës 1, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij neni, si dhe menjëherë në rastet e				
--	--	--	--	--	--	--

		mbarimit të mandatit përpara afatit ligjor, njofton organin e emërtesës për vendin vakant. Procedura për emërimin e gjyqtarit të ri përfundon jo më vonë se 60 ditë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese që ka deklaruar përfundimin e mandatit”. Nëse Kryetarja e Gjykatës vlerëson se 25 Prilli 2025 nuk është data e përfundimit të mandatit të anëtares znj. Sonila Bejtja, mbi cilën bazë ligjore është bërë ky vlerësim?				
--	--	--	--	--	--	--

3.	04.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me kërkesën që ka ardhur nga Presidenti i Republikës, më 30 janar 2025, mbi një interpretim të skemës së ripërtëritjes së Gjykatës Kushtetuese. Më konkretisht pyetjet e gazetares së Reporter TV janë: 1. A po trajtohet kërkesa e Kreut të Shtetit me përparësi për shkak të kërkuarit dhe natyrës së çështjes? 2. Në çfarë faze administrative apo gjyqësore është kjo kërkesë?	13.03.2025	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se në Gjykatën Kushtetuese është paraqitur dhe regjistruar me nr. 1 (P) 2025, datë 30.01.2025 në Regjistrin Themeltar të Kërkesave, kërkesa e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, me objekt: <i>“Deklarimi i mbarimit të mandatit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese”</i>. Kërkesa është në fazën e shqyrtimit paraprak dhe do të merret në shqyrtim sipas parashikimeve të nenin 47, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	---	---------	--------

		3. A do të marrë pjesë në gjykimin e kësaj çështjeje gjyqtarja Sonila Bejtja, e cila më së paku, indirekt është objekt i kësaj kërkesë				
--	--	--	--	--	--	--

4.	04.03.2025	Kërkesë për informacion për vënien në dispozicion pa vonesë, të një kopjeje elektronike të korrespondencës dhe të përgjigjes së dhënë nga SPAK duke qenë se përgjigja nuk nuk përmban klasifikime konfidencialiteti, referuar konferencës për shtyp, të zhvilluar nga Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese, znj. Zaçaj më datë 24.02.2025, gjatë së cilës u njoftua se Gjykata Kushtetuese i ishte drejtuar zyrtarisht SPAK mbi një përgjim apo hetim të mundshëm për anëtarët e kësaj Gjykate.	13.03.2025	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju lutem gjeni bashkëlidhur shkresën e Gjykatës Kushtetuese drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, datë 19.02.2025. Po ashtu, ju bëjmë me dije se përgjigja e ardhur nga SPAK nuk mund t'ju vihet në dispozicion pasi shkresa është e klasifikuar si sekret hetimor.	E plotë	Nuk Ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

5.	06.03.2025	Kërkesë për informacion për vënien në dispozicion nga Gjykata Kushtetuese të një kopje të procesverbalit të mbajtur në seancën plenare mbi bazë dokumentesh në datën 19.12.2024, që i përket çështjes me nr. 12 (P) 2024 Regjistri Themeltar me kërkues Pëllumb Gjoka dhe me objekt: “Shfuqizimi i vendimeve nr. 94, datë 23.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar;nr. 97, datë 29.07.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 38, datë	13.03.2025	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju lutem mbani në konsideratë se gjykata nuk mund të vendosë në dispozicion procesverbalin e mbajtur në seancën plenare mbi bazë dokumentesh në datën 19.12.2024, që i përket çështjes me nr. 12 (P) 2024 Regjistri Themeltar, pasi në përputhje me nenin 37, pika 4 e Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese “...vetëm palët në proces mund të pajisen me kopje të regjistrimit audio të seancës plenare publike, transkripte të plota ose të pjesshme të këtij të fundit, si dhe kopje të procesverbalit të seancës plenare”.	E plotë	Nuk ka
----	------------	--	------------	--	---------	--------

		31.08.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krim in e Organizuar; nr. 00-2023-2238 (364), datë 22.12.2023, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, për pjesën që kanë disponuar për caktimin dhe vazhdimin e masës së sigurimit personal “Arresti në burg” ndaj kërkuarit.Shfuqizimi ishkronjave “a” dhe “b” të pikës 1 dhe i pikës 4 të nenit 6, si dhe i pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 95/2016, datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e		Po ashtu, për sa i përket seancës së datës 30.12.2025, ju informojmë se Gjykata Kushtetuese është mbledhur në dhomë këshillimi për të diskutuar dhe marrë vendim për çështjen. Sipas parashikimeve të nenit 39, pika 3, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, diskutimet e gjyqtarëve dhe votimi për marrjen e vendimit janë të mbyllura dhe konfidenciale.		
--	--	--	--	---	--	--

		<i>institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës Shqipërisë, për shkak se cenojnë pavarësinë dhe paanësinë e gjykatësve të posaçëm.”.</i>				
--	--	--	--	--	--	--

6.	14.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me raportin më të fundit që ka nxjerrë Gjykata Kushtetuese për çështjet që janë trajtuar prej saj. Gjithashtu, kërkohet numri i kërkesave të mbartura nga vitet e kaluara si dhe numri i çështjeve që janë jashtë afatit ligjor për shqyrtim.	26.03.2025	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, lutem gjeni me poshtë informacionin e vënë në dispozicion nga Gjykata Kushtetuese: 1.Në muajin janar të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese ka publikuar “Statistika për veprimtarinë gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese për vitin 2024”, si dhe raportin vjetor për vitin 2024, linqet si më poshtë: https://ëëë.gjykatakushtetuese.gov.al/ëpcontent/uploads/2025/03/STATISTIKA-PER-VITIN-2024.pdf https://ëëë.gjykatakushtetuese.gov.al/ëpcontent/uploads/2025/02/Raporti-Vjetor-Gjykata-Kushtetuese-2024.pdf 2.Në muajin janar të vitit 2025, Gjykata Kushtetuese ka mbartur 104 çështje nga viti 2024, të cilat	E plotë	Nuk ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

				ndërkohë janë marrë në shqyrtim sipas afateve ose janë në shqyrtim brenda afateve procedurale. 3.Theksojmë se, aktualisht, Gjykata Kushtetuese <u>nuk ka në shqyrtim asnjë çështje jashtë afateve procedurale</u>, sipas parashikimeve të ligjit organik dhe Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese duke sqaruar se: -Janë respektuar të gjitha afatet procedurale të kërkesave, në përputhje me parashikimet e ligjit organik të Gjykatës, si dhe me Rregulloren për Procedurat Gjyqësore në Gjykatën Kushtetuese; -Mesatarja e shqyrtimit të çështjeve në Gjykatë për vendimet		
--	--	--	--	--	--	--

				përfundimtare është 8 muaj dhe për vendimet e moskalimit 3 muaj; -Aktualisht, Gjykata Kushtetuese nuk ka në shqyrtim asnjë çështje të prapambetur; -Nuk është paraqitur asnjë kërkesë për tejzgjatje të procesit para Gjykatës Kushtetuese.		
--	--	--	--	--	--	--

7.	17.03.2025	Kërkesë për informacion në lidhje me informacionin e bërë publik në media të ndryshme sipas të cilit, në datë 6 Shkurt 2025 Ministria e Drejtësisë rezulton se ka kryer një pagesë prej 1.5 Milion Euro, si likujdim i faturës së datës 3 Shkurt e cila rezulton të jetë kryer për organizimin e konferencës Ndërkombëtare “Kongresi Botëror i Drejtësisë — 2027”. Më konkretisht kërkohet: 1- Vënia në dispozicion e praktikës së Gjykatës Kushtetuese lidhur me	04.04.2025	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion me nr. 228 prot., datë 17.03.2025, bazuar në nenin 11 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, të ndryshuar, e cila është administruar pranë Gjykatës Kushtetuese me nr. 278 prot., datë 18.03.2025, ju informojmë si më poshtë: Shoqata Botërore e Juristëve (ËJA) është një prej shoqatave më prestigjioze ndërkombëtare të juristëve, e promovuar në vitin 1957 nga Ëinston Churchill dhe e themeluar nga Charles Rhyne, President i Dhomës Amerikane të Avokatisë, me mbështetjen e Presidentëve Eisenhoëer dhe	E plotë	Nuk Ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

		aktivitetin në fjalë, për të cilën flet Ministria e Drejtësisë. 2- Vënia në dispozicion e të gjitha komunikimeve zyrtare ndërmjet Gjykatës Kushtetuese dhe Ministrisë së Drejtësisë, Kryeministrisë dhe Shoqatës Botërore të Juristëve (Ëord Jurist Association — ËJA) dhe Ministrisë së Financave lidhur me këtë event. 3- Sa ditë do të zgjasë ky aktivitet ndërkombëtar i parashikuar të kryhet në vitin 2027, pra pas dy vitesh nga sot, dhe cilët parashikohen të jenë pjesmarrësit apo të ftuarit e tij;		Kennedy. Që prej themelimit të saj në vitin 1963, misioni i Shoqatës Botërore të Juristëve ka qenë "Një botë e sunduar nga ligji, dhe jo nga forca". ËJA u krijua si një përgjigje ndaj thirrjes ndërkombëtare për një forum të lirë dhe të hapur ku gjyqtarë, avokatë, profesorë të së drejtës dhe profesionistë të tjerë nga mbarë bota mund të punonin së bashku për të forcuar dhe zgjeruar sundimin e ligjit dhe institucionet e tij kudo në botë. Si një organizatë jo-qeveritare me status të veçantë konsultativ në Këshillin Ekonomik dhe Social të Kombeve të Bashkuara, ËJA ofron një forum unik për komunitetin ndërkombëtar, duke punuar ngushtë me qeveritë, organizatat jo-qeveritare dhe shoqatat ndërkombëtare për të	
--	--	---	--	---	--

		4- Cilat janë tërësia e shërbimeve/shpenzimeve ose zërave të shpenzimeve, që në totalin e tyre kapin shumën prej 1.5 Milion Euro? 5- A është kjo shuma finale që shteti shqiptar do shpenzojë për këtë aktivitet ndërkombëtar, apo do të këtë pagesa të tjera shtesë në të ardhmen, si për Fondacionin, si për kostot e mbajtjes dhe organizimit të këtij event ndërkombëtar? Nëse po, sa parashikohet konkretisht të jenë këto shpenzime? 6- Si është përzgjedhur ky event ndërkombëtar për t'u paguar nga Qeveria/Shqiptare/Ministria e Drejtësisë? Cili ka qënë roli		nxitur një dialog bashkëpunimi për paqen botërore. Nëpërmjet mbështetjes së kësaj shoqate, vendimmarrësit nga e gjithë bota punojnë së bashku si individë, më shumë sesa si përfaqësues të një vendi, klase apo ideologjie të caktuar. Me më shumë se 60 vjet arritje, ËJA është një nga organizatat e pakta që punon me një gamë kaq të gjerë aktorësh për promovimin e sundimit të ligjit, si rrugën drejt paqes botërore. Anëtarët e kësaj organizate përfshijnë kryetarë gjykatash në detyrë dhe të dalë në pension, gjyqtarë, zyrtarë qeveritarë, profesorë të drejtësisë, avokatë, studentë të drejtësisë dhe profesionistë të lidhur me ligjin. ËJA mbetet e përkushtuar për vazhdimësinë e punës dhe	
--	--	--	--	--	--

		i Gjykatës Kushtetuese? Po ky subjekt/fondacion si është përzgjedhur konkretisht, mbi bazën e cilit kuadër ligjor është përzgjedhur ky subjekt dhe mbi bazën e cilave kriterë ligjore është kryer ky kontraktim. 7- A është përfshirë Gjykata Kushtetuese në këto negocime? Nëse po, cilët kanë qenë personat e kontaktit si dhe lutemi na vendosni në dispozicion dokumentat dhe komunikimet (përfshirë e/mail) lidhur me negociimin e marrëveshjes për këtë event.		përpyjekjeve të saj për garantimin e paqes përmes sundimit të ligjit për të gjitha brezat. Kjo shoqatë bashkëpunon ndër të tjera me gjykata kushtetuese dhe të larta/të kasacionit në Evropë dhe në mbarë botën. Gjatë dy viteve të fundit, bashkëpunimi me Gjykatën Kushtetuese të Shqipërisë është konkretizuar nëpërmjet pjesëmarrjes së kësaj gjykate në veprimtaritë e organizuara nga Shoqata Botërore e Juristëve (ËJA), si më poshtë: -Kongresi i 28-të Botëror i Ligjit, Neë York, USA, datat 20 – 21 korrik 2023, si dhe veprimtaritë e tjera që janë organizuar në kuadër të këtij Kongresi;		
--	--	--	--	--	--	--

				-Ceremonia e zhvilluar për nder të gjyqtarit Anthony Kennedy, ish-anëtar i Gjykatës së Lartë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në formën e një tryeze të rumbullakët me referime nga të gjithë pjesëmarrësit, Madrid, Spanjë, datat 4 – 5 mars 2024; -Vizita e punës pranë Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, në datat 5 – 8 tetor 2024, e një delegacioni nga Shoqata Botërore e Juristëve; -Ftesa dhe konfirmimi i pjesëmarrjes në Kongresin e ardhshëm Botëror të Ligjit, i cili do të zhvillohet në Santo Domingo, Republika Domenikane, datat 4 – 6 maj 2025.		
--	--	--	--	--	--	--

				Ndërkohë, gjatë Kongresit të XIX-të të Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (<i>Conference of European Constitutional Courts – CECC</i>), të mbajtur në Moldavi në maj të vitit 2024, Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë është votuar me shumicë të cilësuar votash dhe është zgjedhur si gjykata kryesuese e kësaj Konference për periudhën 2024-2027, dhe si vendi organizator i Kongresit të ardhshëm të saj, në maj të vitit 2027. Përmes kësaj zgjedhjeje, gjykatat anëtare vlerësuan se Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë jo vetëm ndan vlera e parime të përbashkëta me institucionet homologe evropiane në fushën e drejtësisë kushtetuese, por gjithashtu reflekton vullnetin dhe angazhimin e plotë që do ta përmbushë me sukses detyrën e	
--	--	--	--	--	--

				rëndësishme të këtij kryesimi, i cili do të kulmojë me zhvillimin e Kongresit të saj të XX-të në Tiranë, në maj të vitit 2027. Si kryesuese e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane dhe si vendi organizator i Kongresit të saj të XX-të, u kontaktua nga Shoqata Botërore të Juristëve (ËJA), e cila ishte e ftuar dhe ndoqi punimet e Kongresit të XIX-të në Moldavi, për të diskutuar mundësinë e organizimit në Tiranë të Kongresit Botëror të Ligjit në vitin 2027, duke qenë se përkonte me Kongresin e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Evropiane (CECC). Për këtë qëllim dhe për të forcuar bashkëpunimin e ndërsjellët, me ftesë		
--	--	--	--	---	--	--

			të Kryetares së Gjykatës Kushtetuese, znj. Holta Zaçaj, në datat 5 – 8 tetor 2024, u zhvillua një vizitë pune në Tiranë e një delegacioni nga Shoqata Botërore e Juristëve, i kryesuar nga z. Javier Cremades, Kryetar i Shoqatës Botërore të Juristëve & Eorld Laë Foundation. Në kuadër të kësaj vizite, delegacioni i Shoqatës Botërore të Juristëve ka zhvilluar takime me trupën e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, me Kryetarin dhe anëtarë të Gjykatës së Lartë, si dhe me Kryetarin dhe përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Emëruesi i përbashkët i diskutimeve gjatë këtyre takimeve ishte rëndësia që mbart për çdo vend demokratik		
--	--	--	---	--	--

				forcimi i shtetit të së drejtës, mbrojtja dhe garantimi i lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Po ashtu, sikundër është përmendur dhe më sipër, Shoqata Botërore e Juristëve organizon periodikisht (çdo dy vjet), në vende të ndryshme të botës, kongrese botërore të drejtësisë (<i>World Law Congresses</i>), duke pasur në fokus vendet me demokraci të brishta ose të reja, ndaj gjatë vizitës në Tiranë, është diskutuar edhe mundësia e avancimit të mëtejshëm të bashkëpunimit me qëllim realizimin në Shqipëri të Kongresit Botëror të Ligjit në vitin 2027. Sa i takon dokumentacionit që kërkoni t’u vihet në dispozicion, sqarojmë se Gjykata Kushtetuese, nuk		
--	--	--	--	---	--	--

				disponon dokumentacion shkresor që lidhet me procesin e hartimit dhe miratimit të VKM-se që referoni, pasi procesi i negociatave të Shoqatës është kryer me qeverinë shqiptare dhe hapat e ndërmarrë nuk e kanë përfshirë Gjykatën Kushtetuese.		
--	--	--	--	--	--	--

8.	21.05.2025	Kërkesë për informacion me objekt vënien në dispozicion të kopjeve të shkresave përcjellë Presidentit të Republikës, Kuvendit të Shqipërisë dhe Gjykatës së Lartë në lidhje me skemën e përtëritjes së mandateve të gjyqtarëve kushtetues, në funksion të çështjes gjyqësore me kërkesë Presidentin e Republikës.	02.06.2025	Në vijim të kërkesës suaj për informacion, ju bëjme me dije se, Gjykata Kushtetuese, bazuar në nenin 29 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore, ka njoftuar palët se në shqyrtimin paraprak të kërkesës me kërkesë Presidenti i Republikës së Shqipërisë dhe objekt: “ <i>Deklarimi i mbarimit të mandatit të Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese</i> ”, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në datën 11.04.2025, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, si dhe thirrjen si	E plotë	Nuk Ka
----	------------	---	------------	--	---------	--------

				subjekte të interesuara në këtë proces të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës së Lartë. Në lidhje me kërkesën tuaj për kopje të shkresave të Gjykatës Kushtetuese për njoftimin e kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, drejtuar palëve në proces – Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Gjykatës së Lartë – bazuar në nenin 17, pika 2, shkronja “dh” të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, ju bëjmë me dije se Gjykata Kushtetuese nuk mund t’ju vendos në dispozicion kopje të këtyre akteve, për aq kohë sa çështja është ende në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.		
--	--	--	--	--	--	--

--	--	--	--	--	--	--